



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

---

Numri i lëndës: 2019:232127  
Datë: 28.03.2025  
Numri i dokumentit: 07064364

**C.nr.704/2015**

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË/Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil**, si gjykatë e shkallës së parë me gjyqtaren Vlerona Maliqi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit R.P nga M., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Z.A., avokat nga M., kundër të paditurit Ivan Pavllloviq me adresë të panjohur, me objekt kontesti kthimin-lirimin e patundshmërisë, jashtë seancës, më datë 28.03.2025, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**I. KONSIDEROHET** e tërhequr padia e paditësit R.P nga Mitrovica, e ushtruar kundër të paditurit I.P.me adresë të panjohur, me objekt kontesti kthimin-lirimin e patundshmërisë, në këtë çështje juridike kontestimore.

**II.** Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

**A r s y e t i m**

Paditësi R.P nga Mitrovica, pranë kësaj gjykate ka ushtruar padi kundër të paditurit Ivan Pavllloviq me adresë të panjohur, me objekt kontesti kontesti kthimin-lirimin e patundshmërisë.

Lidhur me këtë çështje, gjykata më datë 13.03.2025, ka nxjerrë aktvendim, me të cilin e ka obliguar paditësin që në emër të shpenzimeve për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm për të

paditurin Ivan Pavllloviq, të deponoj në arkën e kësaj gjykate shumën në lartësi prej 1,000.00€ brenda afatit prej 3 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, duke e paralajmëruar edhe për pasojat e mosveprimit konform të njëjtit.

Nga fletëkthesa për dorëzim personal e cila gjendet në shkresat e lëndës rezulton se i autorizuari i paditësit, aktvendimin e lartëcekur e ka pranuar më datë 20.03.2025 dhe data e fundit për të vepruar konform tij ka qenë data 23.03.2025, respektivisht data 24.03.2025 pasi që data 23.03.2025 ka qenë ditë vikendi kur edhe nuk punon gjykata, mirëpo deri në kohën e nxjerrjes së këtij aktvendimi nuk ka vepruar konform tij, andaj gjykata duke u bazuar në dispozitën e nenit 81 par.2 të Ligjit Nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK), e cila parasheh se është pala paditëse ajo e cila duhet të bëj deponimin e shpenzimeve për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm për palën e paditur, lidhur me dispozitën e nenit 102 par.3 të LPK-së, e cila përcakton se: *“Do të konsiderohet se është tërhequr parashtrësia po që se nuk i kthehet gjykatës brenda afatit të caktuar, e në qoftë se i kthehet pa u korrigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar, parashtrësia do të hidhet poshtë.”*, vendosi si në pikën I të dispozitivit.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 450 të LPK-së.

Nga sa u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**  
**Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil**  
**C.nr.704/2015 më datë 28.03.2025**

**G j y q t a r j a**

---

**Vlerona Maliqi**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit, Gykatës së Apelit në Prishtinë e nëpërmes kësaj gjykate.